



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 09.03.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës , në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040 , nenit 8,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, si dhe në harmoni me rekomandimin e Komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për mbështetje financiare të Klubit Hendbollistik “Shqiponja” nga Gjakova, me dt: 09.03.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e Klubit Hendbollistik “Shqiponja” nga Gjakova nr. 10-400-12083 e dt: 10.02.2015 për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të këtij klubi , përkatësisht për organizimin e turnirit ndërkombëtar në hendboll “Shqiponja- 2000” , duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 2,000.00 € .

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 2,000.00€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e Klubit të Hendbollit “Shqiponja” nr. 1505001002005561 Raiffeisen Bank.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

CO: - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Klubit të Hendbollit “Shqiponja” , Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila